



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 25.7.2024

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, kërkimet dhe prapësimet e palëve, Komisioneri Publik, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

I. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Në lidhje me shkakun ankimor mbi ligjshmërinë e burimeve të shumave të deklaruara, të përfituara “*në formën e dhurimeve nga persona të tjerë të lidhur*” (prindërit e bashkëshortit, në rastin konkret), parë kjo e fundit në raport me pagimin e detyrimeve tatimore për to, trajtuar në prg. 14.1 e vijues, në ankimin e datës 5.5.2021, Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit¹, vlerëson se orientimi i dhënë nga Kolegji e ka ezauruar këtë shkak ankimi.

2. Lidhur me shkakun ankimor mbi zërin “*Hua në vlerën 30.000 euro*”, Komisioneri Publik, pas vlerësimit të prapësimeve të subjektit dhe akteve të depozituara gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji, si dhe në kuadër të evoluimit të jurisprudencës së Kolegjit,² në raste të ngjashme mbi detyrimin e subjekteve në drejtim të verifikimit të mundësisë financiare të huadhënësve, vlerëson se në rastin në fjalë, referuar rrethanave konkrete, mangësitë e

¹ Kolegji ka elaboruar këtë qëndrim në jurisprudencën e tij, referuar vendimi (JR) nr.15/2021.

² Referohuni, ndër të tjerë, vendimit (JR) ***.***. datë 22.5.2024; vendimit (JR) nr. 47/2023; (JR) nr. 45/2023; (JR) nr.2/2023 etj.

konstatuara, lidhur me dokumentimin e plotë të rrethanave faktike për kalimin e shumës së deklaruar si të marrë hua, nuk ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

3. Për sa i përket analizës financiare mbi burimet e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, zërave respektivë të analizës dhe efektit financiar që ato japin në vlerësimin përfundimtar, sikundër trajtuar në qëndrimin dhe aktet e paraqitura në seancën e datës 19.7.2024, Komisioneri Publik, bazuar në gjendjen që janë aktet e administruara dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, arsyeton si më poshtë:

3.1 Bazuar në nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit për të zbatuar çdo skenar të mundshëm garantist³, me qëllimin për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e kontrollit të pasurive, si dhe bazuar në faktet që kanë rezultuar të provuara nga aktet në dosje, Komisioneri Publik vlerëson të marrë në konsideratë prapësimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me mënyrën e deklarimit të *kursimeve cash*, në deklaratat periodike vjetore, përfshirë vitin 2013.

3.2 *Mbi të ardhurat e deklaruara nga qiradhënia e apartamentit të banimit në Tiranë, për vitet 2011- 2015*, nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se:

3.2.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja në vlerën totale 2.950.000 lekë dhe ka deklaruar se nga çmimi i qirasë është zbritur tatimi mbi të ardhurat individuale.

3.2.2 Në deklaratat e interesave privatë vjetorë periodikë, të cilat konsiderohen si burim prove në procesin e rivlerësimit, parashikuar nga neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhënien me qira të apartamentit në Tiranë, në vitet 2010 - 2015, përkatësisht në shumat 300.000 lekë, për 6 muajt e vitit 2010, dhe nga 600.000 lekë, për të gjitha vitet në vazhdim deri në vitin 2015.

3.2.3 Në dosjen e Komisionit është administruar akti noterial “Kontratë qiraje” nr. *** rep./*** kol., datë **.6.2010, lidhur nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me shtetasin ***. ***, ku është përcaktuar vlera e qirasë mujore prej 50.000 lekë, në të cilën parashikohet po ashtu se: [...] *afati i kontratës fillon me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon kur ta kërkojë një gjë të tillë pala qiradhënëse* [...].

3.2.4 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 4, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *Pallati nuk është regjistruar akoma, pasi subjekti ndërtues ka tejkaluar lejen e ndërtimit dhe nuk kam banuar asnjëherë aty, por banesa është përdorur nga qiramarrës të ndryshëm dhe pagesat janë kryer nga këta të fundit. Kontratat janë ende në emër të njërit nga bashkëpronarët e truallit⁴ [...], duke vënë në dispozicion dhe dokumentacionin, nga ku rezulton se kontratat e shërbimeve të ***-së dhe ***-së janë ende në emër të bashkëpronarit të truallit dhe nuk ka detyrime të pashlyera ndaj këtyre shoqërive.*

3.2.4.1 Nga aktet e administruara si më sipër, rezulton po ashtu se, gjatë këtyre viteve, ka pasur konsum të utiliteteve në këtë pasuri, rrethana që e bëjnë të besueshëm deklarinimin e subjektit të

³ Referohuni vendimeve (JR) nr.1/2021; nr. 8/2021; nr.18/2021 të Kolegjit.

⁴ Subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur: (i) Vërtetimin nr. *** prot., datë **.5.2020, nga *** (ish-***), ku ka vërtetuar se kontrata me Kod ***, nuk ka detyrim për faturat e energjisë, si dhe (ii) Vërtetimin nr. ***/* prot., datë **.5.2020, ku ka vërtetuar se kontrata me nr. ***. është regjistruar në emër të bashkëpronarit të truallit.

rivlerësimit mbi marrëdhënien e qiradhënies në kohën e pretenduar, referuar dhe arsyetimit të Kolegjit në situata të ngjashme⁵.

3.2.5 Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se, në datën ***1.2017*, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, janë paguar, nëpërmjet llogarisë së tij pranë ****-së*, detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiraja, për periudhën 2011 deri në 2015⁶, ndërkohë që Deklarata “Vetting” rezulton e dorëzuar më datë ***1.2017*.

3.3 *Mbi të ardhurat nga shitja e librit të bashkëshortit në vitin 2011*, nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se:

3.3.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë *Apartament* në ***** edhe të ardhurat nga shitja e librit universitar “*Matematika për Fakultetin e Ekonomisë*”, në vlerën 365.000 lekë.

3.3.2 Në deklaratën periodike të vitit 2011, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura nga shitja e librit universitar “*Matematika për Fakultetin e Ekonomisë*”, në vlerën 365.000 lekë.

3.3.3 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit rezulton, se në datën ***11.2011*, llogaria e tij pranë **** Bank* është kredituar për shumën 350.000 lekë, me përshkrimin: “*Likuidim për 234 libra ***. ***.*”.

3.3.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur “*Kontratë porosie*” (akt i thjeshtë), datë ***9.2011*, lidhur ndërmjet bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe personit fizik ****. ***.*, me objekt: “*Porosi për shitjen e librit universitar...*”. Në nenin 5/3 të kësaj kontrate, parashikohet se: [...] *secili pranon të paguajë tatimin në burim (i llogaritur mbi të ardhurat përkatëse, përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 5 [...]).*

3.3.5 Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, në datën ***01.2017*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, së bashku me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja e apartamentit, ka paguar nëpërmjet llogarisë së tij pranë ****-së*, dhe detyrimet tatimore për të ardhurat nga shitja e librit në vitin 2011.

3.4 *Komisioneri Publik*, në konkluzion të analizës faktike dhe ligjore si më sipër, duke mbajtur në konsideratë se Kolegji orientimin për institucionet e rivlerësimit e bën nëpërmjet vendimeve të dhëna, sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁷, vlerëson se, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit⁸, të mos përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme, të ardhurat për të cilat rezulton se detyrimet tatimore janë paguar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, edhe kur kjo pagesë është kryer përpara dorëzimit të Deklaratës “Vetting”, pagesa këto, të cilat në praktikën e Kolegjit janë konsideruar si të kryera për efekt të procesit të rivlerësimit.

3.4.1 Bazuar në sa më sipër, si dhe për sa trajtuar gjerësisht edhe në parashtrimet dhe aktet e depozituara në seancën e datës 19.7.2024, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i

⁵ Referohuni vendimit (JR) nr. 2/2023, prg. 17.11 të Kolegjit.

⁶ Nuk rezulton të jenë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiraja në shumën 300,000 lekë, të deklaruara në vitin 2010 dhe, për këtë arsye, Komisioni këto të ardhura, në shumën 300.000 lekë, nuk ia ka marrë në konsideratë në analizën financiare të këtij vitit si të ardhura me burim të ligjshëm.

⁷ Referohuni, ndër të tjera, dhe vendimit (JR) nr. 8/2019 të Kolegjit.

⁸ Referohuni vendimit (JR) nr.15/2021 të Kolegjit.

rivlerësimi rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën rreth 3,6 milionë lekë, për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara ndër vite, vlerë kjo që nuk mund t'i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit, parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe standardit të vendosur nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit⁹.

3.4.2 Në këtë vlerë pamjaftueshmërie të lartpërmendur, të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga qiraja e apartamentit për vitet 2011-2015 janë në total në shumën 2,4 milionë lekë¹⁰, kurse pjesa tjetër e diferencave negative të konstatuara ndër vite, për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve është e lidhur me: (i) shpenzimet e jetesës të vitit 2007, (ii) përjashtimin e të ardhurave të përfituara në formën e dietave, si dhe (iii) shpenzimet e udhëtimit¹¹.

3.4.3 Në përfundim, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, arrijmë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin një nivel të besueshëm për vlerësimin e këtij kriteri, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

II. Për kontrollin e aftësive profesionale

4. Në lidhje me shkakun ankimor mbi gjetjet e kriterit profesional, Komisioneri Publik vlerëson se, dhe pas parashtrimeve të subjektit gjatë shqyrtimit të shkaqeve të ankimit në Kolegj, mbeti e pandryshuar situata faktike dhe rrethanat e konstatuara, lidhur me vendimin penal nr. ***, datë **.6.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë, i evidentuar nga aktet e përcjella nga KLGJ-ja, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të subjektit të rivlerësimit.

4.1 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se ky rast duhet vlerësuar nga Kolegji së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

III. Konkluzione

5. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 3/5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

⁹ Referohuni vendimit (JR) nr.31/2020 dhe vendimit (JR) nr. 18/2021, datë 12.7.2021, të Kolegjit.

¹⁰ Kjo vlerë i referohet të ardhurës së deklaruar nga qiradhënia vetëm për vitet 2011-2015, pasi të ardhurën e deklaruar për vitin 2010, vetë Komisioni nuk rezulton ta ketë përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të këtij viti, si rezultat i mosdokumentimit të pagesës së detyrimeve tatimore për të.

¹¹ Për sa trajtuar dhe referuar në parashtrimet dhe aktin e depozituar nga Komisioneri Publik në seancën e datës 19.7.2024.